



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
AKADEMISË SË DREJTËSISË  
PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, qershor 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Fatmir Mehmeti, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.


## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	14
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	16

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Akademisë së Drejtësisë (AD) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli - AD në përgjithësi kishte kontrole të mira, megjithatë kemi vërejtur dobësi sa i përket mos regjistrimit të pasurive mbi 1,000 € si dhe kontrollit lidhur raportimin e obligimeve të papaguara.

Zbatimi i rekomandimeve - në raportin e vitit të kaluar AD kishte tri rekomandime, prej të cilave dy kishte adresuar dhe një ende mbetet i pa adresuar.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

#### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i AD-së është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionin e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimin e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të AD-së gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

---

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Akademisë së Drejtësisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Akademisë së Drejtësi (AD) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga AD-ja. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Drejtori Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Akademisë së Drejtësisë.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AD në përgjithësi ka kontrole të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Megjithatë, nevojiten kontrole të duhura sa i përket regjistrimit të pasurive mbi 1,000€ si dhe kontrollit lidhur me raportimin e obligimeve të papaguara.

## 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,433,309</b>	<b>1,157,259</b>	<b>1,116,496</b>	<b>96%</b>	<b>606,355</b>	<b>516,769</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	883,309	589,616	554,275	94%	575,098	515,672
Të hyrat nga AKP	550,000	550,000	550,000	100%	-	-
Donacionet e jashtme	0	17,643	12,221	69%	31,257	1,097

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 276,050€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2019, AD ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 1,116,496€, me një përmirësim prej 14% krahasuar me vitin 2018, ku shpenzimi ishte 82%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,433,309</b>	<b>1,157,259</b>	<b>1,116,496</b>	<b>96%</b>	<b>606,355</b>	<b>516,769</b>
Pagat dhe Mëditjet	265,409	195,716	195,716	100%	185,051	185,825
Mallrat dhe Shërbimet	590,400	388,043	350,509	90%	398,520	310,945
Shërbimet komunale	14,500	10,500	8,521	81%	9,904	10,258
Investimet Kapitale	563,000	563,000	561,750	99.8%	12,880	9,741

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 69,693€;
- Zvogëlim të buxhetit final kishte edhe te kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 202,357€ si dhe të shërbimet komunale në vlerë 4,000€; ndërsa

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Kategoria e investimeve kapitale nuk kishte ndryshime buxhetore.

Ndryshime buxhetore kishin ndodhur me vendim të Qeverisë me Nr.03/115 të datës 17.12.2019 për kursime buxhetore si dhe donacioneve.

### 2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 195,716€, aq sa edhe ishin shpenzuar. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 33 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 29. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 9 të rinj. Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 26,324€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

### 2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 388,043€, ndërsa ishin shpenzuar 350,509€. Te shpenzimet komunale buxheti ishte 10,500€, prej të cilave ishin shpenzuar 8,521€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përfshijnë shpenzimet e përkthimit dhe trajnimit, shpenzimet e qerasë, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet komunale dhe të tjera.

Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 33,349€ si dhe 14 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

### 2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 563,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 561,750€. Ato kanë të bëjnë me ndëtimin e objektit të AD-së dhe blerjes së një softueri. Kemi testuar 2 mostra për teste substanciale në vlerë 337,856€, si dhe dy mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 10,700€, pasurive jokapitale është 100,377€, si dhe e stoqeve 18,525€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 31,216€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

AD kishte arritur një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Administratës Publike që menaxhimin e realizimit të projektit kapital për ndërtimin e objektit të AD-së t'ia bart kësaj të fundit. Si rezultat i kësaj, edhe pse AD kishte paguar nga buxheti i saj dy pagesa në vlerë 223,894€ të cilat ishin për investimet në vijim të ndërtesës së AD-së, nuk ishin regjistruar si investime në vijim në regjistrin e pasurive kapitale mbi 1,000€.

Lidhur me këto ne kemi vërejtur si në vijim:

---

## Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës

**Gjetja** Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rreg. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Gjatë testimeve kemi vërejtur që AD nuk kishte regjistruar një pagesa në vlerë 11,750€ për blerjen e një softueri në regjistrin e pasurive kapitale mbi 1,000€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë që pasuria të regjistrohet në regjistrat e saj.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës reflekton me prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV-të e AD-së.

**Rekomandimi B1** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet t'i sigurojë të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezentimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

## 2.3 Detyrimet

### 2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 2,649€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Lidhur me raportimin dhe pagesën e obligimeve ne kemi identifikuar si në vijim:

## Çështja A1 - Dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Sipas rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 dhe 6, citon që raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në afat prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak. Kurse sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1, të LMFP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të faturës.

AD kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo në 4 pagesa apo fatura në vlerë 4,734€, ne kemi vërejtur që ato ishin detyrime në muaj të caktuar, mirëpo siç kërkohet me rregulloren e obligimeve, ato nuk ishin raportuar si të tilla në MF. Madje prej tyre, kishte vonesa nga dy ditë deri në 16 ditë, përtej afatit 30 ditë të lejuar.

**Ndikimi** Vonesa në pagesa dhe mos raportimi i obligimeve mujore ndikon në raportim jo të drejtë si dhe rrit rrezikun që faturat të mos paguhen me kohë.

**Rekomandimi A1** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF dhe në PFV në fund të vitit.

### 2.3.2 Detyrimet kontigjente

AD nuk kishte detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 në PFV. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

### 2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 77,977€<sup>3</sup>. AD-ja kishte kontrata të cilat ishin nënshkruar nga Autoriteti Qendror i Prokurimit, prej të cilave disa ishin kontrata kornizë e disa me çmime për njësi. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

## 2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave ligjore, AD-ja nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që

<sup>3</sup> Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 ka rezultuar në tri (3) rekomandime kryesore. AD-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, dy (2) rekomandim ishin zbatuar dhe një (1) nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj që me rastin e hartimit të PFV informatat financiare për pasuritë prezantojnë vlerën e drejtë dhe të plotë të tyre. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Edhe këtë vit kemi verjetur që pasuritë nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive mbi 1,000€.	I përsëritur.
2	Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj që procesi i angazhimit të trajnuesve të përkohshëm të kryhet me kohë, duke siguruar proces transparent dhe angazhim i tyre të bëhet vetëm nëse ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara.	Ky proces ka përfunduar. Nuk kemi identifikuar raste tjera.	I adresuar.
3	Pasuritë Kapitale dhe jokapitale	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive përfundojnë detyrat e ngarkuar me kohe, dhe të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjithë pasurive jo financiare, si dhe të harmonizojnë raportin e pasurive me raportet e inventarizimit dhe vlerësimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurisë në PFV.	AD kishte themeluar me kohë dhe kishte përfunduar raportin e inventazimit.	I adresuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Pasuritë Kapitale dhe jokapitale	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet t'i sigurojë të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezentimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.		
2	Detyrimet e papaguara	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF dhe në PFV në fund të vitit.		

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO			
AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Nr. Prot. (Reg. No.)	02	Nr. Prot. (Reg. No.)	130
Nr. Faqeve (No. Pages)	1	Data (Date)	26.05.2020
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova/Republic of Kosovo**

*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Enver Fejzullahu.....

Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë,

Data: 26 Maj 2020, vendi, Prishtinë

